

**RELACION  
PËR  
PROJEKTLIGJIN “PËR MBËSHTETJEN DHE ZHVILLIMIN E  
STARTUP - EVE INOVATIVE”**

**I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË  
ARRIHEN**

Projektligji ka për qëllim krijimin i një kuadri rregullator dhe institucional i cili mbështet dhe favorizon krijimin dhe zhvillimin e bizneseve të reja me potencial të lartë rritjeje, në fushën e teknologjisë dhe inovacionit, të njohura botërisht si Startup-e Inovative, të cilat realizojnë ide, modele, produkte dhe procese të reja biznesi, të cilat sjellin risi dhe përmirësim të ndjeshëm në çdo fushë të ekonomisë.

Ky projekt ligj synon të plotësojë boshllëkun ligjor ekzistues, pasi në Republikën e Shqipërisë deri më sot, nuk ka patur dispozita të cilat rregullonin situatat e lidhura me Startup-et inovative.

Objektivat që synohen të arrihen përmes miratimit të këtij projektligji dhe zbatimit të tij janë:

- Përcaktimi i lehtësirave fiskale, programeve dhe masave që mbështesin Startup-et Inovative në fazën fillestare të biznesit (periudha e inkubimit) dhe krijimin e një eko-sistemi të favorshëm për to në Republikën e Shqipërisë;
- Organet shtetërore të cilat ngarkohen me detyrat dhe kompetencat për mbështetjen e Startup-eve Inovative;
- Përcaktimi i kriterëve, rregullave dhe procedurat që zbatohen për miratimin, mbështetjen, vlerësimin dhe monitorimin e Startup-eve Inovative.

**II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN  
POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN  
ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA  
POLITIKE**

Projektligji është në përputhje me programin politik të Këshillit të Ministrave, pasi ndikon drejtpërdrejt në krijimin e bizneseve të reja dhe zhvillimin ekonomik të vendit.

Në mënyrë të veçantë, projektligji objektivat dhe prioritetet e Strategjisë Kombëtare për Shkencën, Teknologjinë dhe Inovacionin 2017 – 2022 e cila përcakton si objektiv të sajin nxitjen e biznesit për krijimin e Sipërmarrjeve të Reja (Start-Up) në Inovacion dhe teknologji (Qëllimi 1: Rritja e bashkëpunimit mes komunitetit të kërkuesëve shkencorë dhe atij të biznesit, Objektiv 3).

Gjithashtu projekti zbaton gjetjet e Strategjisë së zhvillimit të biznesit dhe investimeve 2014-2020 e cila përcakton se ende mungojnë politikat mbështetëse për bizneset start-up dhe mungojnë burimet financiare alternative si venture capital, innovation vouchers, business angels, etj (ref 3.1.6. Sfidat për zhvillimin e SME-ve). Projektligji zbaton disa nga qëllimet specifike të strategjisë (Ref 2.iii - Zhvillimi i biznesit inovativ dhe 2.iv -Zhvillimi i SME-ve dhe sipërmarrjes), sipas të cilave synohet rritja e aplikimit të teknologjive të reja, rritja çdo vit e numrit të ndërmarrjeve të reja dhe atyre inovative dhe futjen e instrumenteve të reja financiare, në veçanti në mbështetjen e atyre bizneseve që që janë në fazën fillestare të tyre (start-up).

Hartimi dhe miratimi i këtij projektligji është parashikuar në planin e përgjithshëm analitik të hartimit të akteve ligjore/nënligjore për vitin 2020.

### **III. ARGUMENTIMI I PROJEKTLIGJIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME**

Projektligji është hartuar si rezultat i nevojës për të krijuar një kuadër ligjor që favorizon krijim e bizneseve të reja në fushën e teknologjisë dhe inovacionit. Botërisht në vitet e fundit është pranuar se risia teknologjike konsiderohet si një nga faktorët kryesorë të rritjes ekonomike dhe punësimin dhe është konstatuar se kompanitë e reja me fokus teknologjinë, renditen tashmë në vendet e para të bizneseve më të mëdha të globit. Teknologjitë e reja të zbatuara nga startup-et inovative kanë revolucionuar modelet e biznesit duke sjellë produkte dhe shërbime të reja në treg. Startup-et lidhen ngushtësisht me inovacionin që ato sjellin, prandaj, ekzistonte nevoja edhe në Shqipëri për të zhvilluar instrumente ligjore për ti stimuluar ato.

Objektivat që synohen të arrihen janë zbatimi i mekanizmave mbështetës për krijimin dhe zhvillimin e Startup-eve të reja, duke nxitur krijimin e një mjedisi të favorshëm dhe duke synuar thithjen e aktorëve që mungojnë aktualisht, kryesisht subjekteve që ofrojnë inkubim, mentorim dhe financim të startup-eve të reja.

Projektligji krijon kuadrin institucional të nevojshëm, duke përcaktuar organet Projektligji krijon kuadrin institucional të nevojshëm, duke përcaktuar organet përkatëse shtetërore dhe kompetencat e tyre, në veçanti duke krijuar Agjencinë Kombëtare për Startup-et “Startup Albania”.

### **IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTESHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR**

Projektligji është në përputhje me nenin 81 të Kushtetutës, dhe implementon qëllimet e Strategjisë Kombëtare për Shkencën, Teknologjinë dhe Inovacionin 2017 – 2022 dhe Strategjisë së zhvillimit të biznesit dhe investimeve 2014-2020.

Projektligji gjithashtu synon ti japë zbatim rekomandimeve të progres raportit të Komisionit të Bashkimit Europian për Shqipërinë, për vitin 2019, i cili për sa i përket teknologjisë dhe inovacionit dhe Startup-eve përcakton se ekziston nevoja për të zhvilluar instrumente ligjore për ti stimuluar Startup-et në drejtim të inovacionit. Komisioni i BE sugjeron zbatimin në praktikë të qëllimeve të Strategjisë Kombëtare të Inovacionit dhe Teknologjisë dhe përparësive të vendit sipas Strategjisë së zhvillimit të biznesit dhe investimeve.

## **V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)**

*Acquis communautaire* nuk ka rregullore apo direktiva specifike që rregullon startup-et, ndaj projektligji nuk transponon specifikisht *acquis communautaire*, por zbaton parimet e EU Small Business Act dhe mekanizma analogë mbështetjeje të aplikuara nga BE dhe shtetet anëtare të saj.

## **V. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT**

Projektligji është konceptuar në gjashtë krerë, duke parashikuar rregullime specifike për secilin kapitull dhe konkretisht:

Kreu I i projektligjit përcakton qëllimin, objektivat si dhe ofron përkufizimet, meqenëse futen koncepte dhe terminologji të reja, që mungonin në legjislacionin ekzistues.

Kreu II i projektligjit përcakton në mënyrë konkrete se cilat janë masat mbështetëse që zbatohen në favor të Startup-eve Inovative dhe aktorëve të tjerë që mbështesin krijimin e një mjedisi të favorshëm për to, të identifikuar si Lehtësues të Startup-eve Inovative.

Masat mbështetëse për Startup-et Inovative përfshijnë në fazën paraprake informacion dhe konsulencë në lidhje detyrimet fiskale dhe procedurat ligjore që zbatohen në Republikën e Shqipërisë pa pagesë, të ofruara nga Agjencia Kombëtare për Startup-et Inovative “Startup Albania si dhe shërbimet e inkubimit, mentorimit dhe mbështetjes së projekt idesë, të ofruara nga Lehtësuesit e miratuar. Për përfitimin e tyre nismëtarët e një startup-i nivativ, lidhin marrëveshje bashkëpunimi me Agjencinë.

Përgjatë periudhës fillestare dy vjeçare të inkubimit të biznesit, Startup-et Inovative, të cilat janë miratuar nga Bordi i Vlerësimit dhe janë regjistruar në regjistrin tregtar, përfitojnë lehtësi fiskale, duke u përjashtuar nga pagesa e taksave vendore e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël, taksa

vendore mbi pasurinë e paluajtshme, kategoria ndërtesë, si dhe nga taksa vendore e tabelës.

Gjithashtu Startup-et Inovative, përgjatë periudhës dy vjeçare të inkubimit, mbështeten me grante financiare, garantim i një pjese të riskut të kreditimit, programe dhe masa të tjera mbështetëse të tilla si pjesëmarrje dhe organizim i eventeve që kanë si qëllim krijimin e rrjeteve të bashkëpunimit, shërbimeve të informacionit dhe konsulencës ligjore dhe fiskale dhe nxitje për përfitimin nga fonde të investimit.

Projektligji, synon të tërheqë edhe praninë e aktorëve private të ekosistemit të Startup-ve Inovative, të cilët kanë kapacitete dhe përvojën e duhur dhe ofrojnë shërbime mbështetëse për zhvillimin e tyre. Shërbimet përfshijnë ofrimin e ambienteve dhe pajisjeve të punës, mentorim, këshillim, trajnim apo duke mundësuar kapital investimi për Startup-et Inovative. Tërheqja e subjekteve financues të Startup-eve redukton nevojat dhe varësinë e tyre nga grantet financiare të subvencionuara nga buxheti i shtetit, siç ndodh aktualisht, duke lehtësuar barrën buxhetore për këtë qëllim.

Lehtësuesit e Startup-eve Inovative, të cilat janë miratuar, përjashtohen nga pagesa e taksës vendore të ndërtesës, për sipërfaqet e tyre të biznesit, të cilat ia venë në dispozicion Startup-eve Inovative të miratuara, për shfrytëzimin nga ana e tyre, si seli ligjore dhe ushtrim veprimtarie biznesi, nëpërmjet kontratave të huapërdorimit pa pagesë të lidhura me to. Përjashtimi nga taksa e ndërtesës zbatohet vetëm përgjatë periudhës dy vjeçare të inkubimit të Startup-it huapërdorues.

Lehtësuesit mund të përfitojnë edhe grante, programe apo masa të tjera mbështetëse, të zbatuara nga Agjencia Kombëtare për Startup-et Inovative apo nga Njësitë e Vetëqeverisjes vendore.

Kreu III i këtij projektligji përcakton kuadrin institucional, duke identifikuar organet përgjegjëse dhe kompetencat e tyre për mbështetjen e Startup-eve Inovative. Projektligji ka identifikuar si organe përgjegjëse ministrinë përgjegjëse për ekonominë, njësitë e qeverisjes vendore, Agjencinë Kombëtare për Startup-et Inovative “Startup Albania” dhe Bordin e Vlerësimit të Startup-eve Inovative.

Për sa i përket përgjegjëse për ekonominë, kompetencat e saj lidhen kryesisht me politikën, miratimin e fondeve buxhetore, rolin koordinues dhe mbikqyrjen e Agjencisë.

Meqenëse mbështetja e Startup-eve nuk do të kishte sukses vetëm nëse organizohet në nivel qendror, projektligji nxit edhe njësitë e vetë qeverisjes vendore, që të ndërmarrin dhe zbatojnë, në përputhje me kompetencat e tyre dhe

brenda territoreve përkatëse, masat mbështetëse të identifikuar nga ky ligj. Ato mund të miratojnë grante, programe apo masa të cilat kanë synim mbështetjen dhe zhvillimin e Stratup-eve Inovative në nivel vendor.

Projektligji, krijon dhe përcakton funksionet e një agjencie autonome e cila do të zbatojë programet mbështetëse sipas këtij projektligji. Përzgjedhja e modelit të një agjencie autonome, u ndikua nga përfundimet e konsultimeve paraprake dhe është hartuar në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", në veçanti me pikat 2 dhe 3 të nenit 10 të tij.

Krijimi i një agjencie autonome justifikohet nga plotësimi i të gjitha kushteve ligjore, që lidhen me faktin se ky organ:

- kryen funksione që kërkojnë specializim të thellë në menaxhim, pasi ofron mekanizma mbështetës specifikë për subjekte dhe veprimtari të posaçme, të cilat në koncepte, terminologji dhe tipologji veprimtarie, janë risi në kuadrin ligjor dhe institucional shqiptar e që kërkojnë një nivel të posaçëm njohjeje të problematikave dhe ekspertizë në hartimin e mekanizmave mbështetës;
- Gjithashtu, agjencia nuk do të ketë nevojë për drejtim dhe mbikëqyrje të përhershme nga ministri përgjegjës për ekonominë, pasi zbaton detyra specifike, në përputhje me politikat dhe fondet e miratuar prej tij;
- Agjencia do të financohet jo vetëm nga buxheti i shtetit, por synon të përfitojë nga sinergjia dhe kontributi i donatorëve, organizatave kombëtare apo ndërkombëtare dhe aktorëve të eko-sistemit që mbështesin Startup-et Inovative, si dhe synon në të ardhmen financimin dhe përfitimin nga bashkëpjesëmarrja në fondet e investimit, siç ndodh me agjencitë analoge të disa prej shteteve anëtare të BE-së.

Funksionet administrative të parashikuara nga projektligji, realizohen më mirë nëpërmjet agjencisë autonome, krahasuar me një ministri apo institucion varësie të ministrive, në përputhje me parimin e ekonomisë, efijencës dhe të efektivitetit.

Arsyet kryesore që motivojnë krijimin e Agjencisë lidhen me disa faktorë:

Së pari, agjencia do të ketë një strukturë të vogël në staf por modern në shërbime, pasi i adresohet inovacionit dhe teknologjisë dhe përfituesve të cilët statistikisht janë të rinj në moshë. Gjithashtu konsultimet e kryera me komunitetin ekzistues treguan se ata skeptikë ndaj zbatimit të ligjit nga ana e një organi i cili përfshihet brenda një ministrie, si pasojë e nivelit të mosbesimit ndaj nivelit aktual të ekspertizës së administratës publike, me qëllim shmangjen e burokracisë, dhe nevojës për fokusimin tek inovacioni, duke patur një sportel unik suporti shtetëror, i formuar nga një staf i ri dhe me ekspertizë specifike.

Një agjenci autonome është një stimul besueshmërie edhe për donatorët, dhe organizatat ndërkombëtare që ofrojnë programe në mbështetje të Startup-eve

inovative dhe një partner i besueshëm e i pavarur, për subjektet private që ofrojnë financime në cilësinë e investitorëve të kapitalit.

Gjithashtu agjencia do të krijojë dhe administrojë dy mekanizma tepër të rendësishëm për Startup-et Inovative, përkatësisht portalin elektronik unik i cili përmban informacionin, legjislacionin dhe të dhënat për komunikimin midis Startup-eve Inovative dhe aktorëve të ndryshëm të eko-sistemit.

Gjithashtu, agjencia krijon dhe administron regjistrin e Startup-eve Inovative, i cili përmban të gjitha të dhënat mbi Startup-et dhe Lehtësuesit e miratuar, aplikimet e paraqitura dhe masat mbështetëse të dhëna.

Projektligji ka përcatuar se Agjencia Kombëtare për Startup-et Inovative, emërtuar si “Startup Albania” krijohet si person juridik publik, buxhetor, me seli në Tiranë, në varësi të ministrit përgjegjës për ekonominë. Agjencia drejtohet nga Drejtori i Përgjithshëm ndërsa rekrutimi dhe marrëdhëniet e punës me personelin e Agjencisë kryhen në përputhje me legjislacionin e shërbimit civil/ose/Kodit të Punës.

Detajet teknike të organizimit dhe funksionimit të brendshëm të Agjencisë do të përcaktohen nga një vendim i Këshillit të Ministrave, ndërsa struktura dhe organika e agjencisë duhet të përcaktohen me urdhër të Kryeministrit.

Neni 11 i projektligjit liston funksionet dhe kompetencat e Agjencisë Kombëtare për Startup-et Inovative, ku përfshihen propozimi i politikave dhe kuadrit rregullator, garantimi i mbështetjes për Startup-et nëpërmjet granteve, programeve dhe masave mbështetëse, administrimi i procesit të aplikimeve, lidhjen dhe monitorimin e marrëveshjeve me përfituesit, administrimi i portalit elektronik unik dhe regjistrin të Startup-eve Inovative.

Ndërsa neni vijues 12 rregullon dispozitat e lidhura me Bordin e Vlerësimit të Startup-eve Inovative, i cili është konceptuar si një organ kolegjal i formuar nga anëtarë të organeve shtetërore kompetente, por edhe përfaqësues të komunitetit të Startup-eve, botës akademike dhe biznesit, duke garantuar autonomi dhe nivel të lartë ekspertize. Kompetenca kryesore e Bordit lidhet me vlerësimin e aplikimeve për miratimin dhe përfitimin nga masat mbështetëse.

Kreu IV i projektligjit përcakton kriteret dhe procedurat për miratimin dhe mbështetjen për Startup-et Inovative dhe Lehtësuesit.

Në mënyrë që të aplikojnë për përfitimin nga masat mbështetëse, propozimet e aplikuesve duhet të vlerësohen fillimisht nëse konsiderohen apo jo si inovative nga Bordi i Vlerësimit e për pasojë, të miratohen si Startup Inovativ.

Pas miratimit, aplikuesit lidhin marrëveshjen e zbatimit me Agjencinë dhe regjistrohen në regjistrin tregtar. Për të përfituar nga mbështetja shtetërore, subjektet duhet të ketë përmasa modeste, të tilla për ta kualifikuar si ndërmarrje,

---

Relacion shpjegues për projektligjin “Për mbështetjen dhe zhvillimin e startup-eve inovative”

mikro, e vogël apo e mesme, autonome, sipas përcaktimeve të legjislacionit për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme dhe në përputhje me dipsozitat e legjislacionit për ndihmën shtetërore.

Për të shmangur abuzimet me fondet apo masat e përfituara, përgjatë periudhës së inkubimit, përfituesit nuk duhet të shpërndajnë dividend apo forma të tjera fitimi, si edhe e ka të ndaluar dhënien e shpërblimeve apo pagave për ortakët, aksionarët, administratorët apo anëtarët e organeve drejtuese, si edhe të punësuarve dhe konsulentëve, në vlera të cilat tejkalojnë kufirin e pesëfishit të pagave mujore minimale. Për nxitjen e formimit të ekosistemit dhe inkubimin profesional të bizneseve të reja, ato duhet të bashkëpunojnë dhe të përfitojnë shërbime të ofruara nga Lehtësuesit e miratuar.

Për sa i përket Lehtësuesve, kushtet paraprake për miratimin dhe përfitimin e masave mbështetëse shtetërore parashikojnë që ata duhet të jenë subjekte tregtare të regjistruara në regjistrin tregtar shqiptar, të kenë kapacitete dhe përvojë, si edhe të ofrojnë shërbime për mbështetjen e Startup-eve Inovative. Shërbimet e ofruara nga Lehtësuesit mund të përfshijnë ofrimin e ambienteve dhe pajisjeve të punës, mentorim, këshillim, trajnim apo duke mundësuar kapital investimi për Startup-et Inovative.

Procedurat e zbatueshme, rregullohen nga nenet 14 dhe 16, të cilët parashikojnë se propozuesit, aplikojnë për miratimin e tyre tek Agjencia e Startup-eve Inovative. Agjencia i përcjell aplikimin dhe dokumentacionin shoqërues Bordit të Vlerësimit të Startup-eve Inovative i cili kryen vlerësimin e dhe nëse aplikimi plotëson kushtet ligjore, miraton aplikuesin si Startup Inovativ apo si Lehtësues dhe Agjencia e regjistron atë në regjistrin e posaçëm. Në zbatim të parimit të transparencës dhe informimit, projektligji parashikon se Agjencia duhet të publikojë grantet, programet dhe masat mbështetëse të cilat do të zbatohen konkretisht. Përzgjedhja e aplikimeve kryhet bazuar mbi procedura konkurruese.

Projektligji vendos edhe rregullat për monitorimin e përfituesve i cili kryhet nga Agjencia dhe detyrimin e raportimeve nga ana e përfituesve, Monitorimi fokusohet tek verifikimi i përputhshmërisë së zbatimit të kriterëve sipas ligjit dhe kushteve të marrëveshjeve të zbatimit për përfitimin e masave mbështetëse.

Në kreun V parashikohen rastet kur verifikohen shkelje të dispozitave ligjore dhe pasojat e tyre, të cilat lidhen me çregjistrimin e përfituesve, ndërprerjen e mbështetjes si dhe aplikimin e gjobave. Autoriteti kompetent për vendosjen e gjobës është Bordi i Vlerësimit të Startup-eve Inovative. Procedura e konstatimit, vendosjes, ankimit dhe ekzekutimit të gjobës kryhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për kundërvajtjet administrative.

---

Relacion shpjegues për projektligjin "Për mbështetjen dhe zhvillimin e startup-eve inovative"

Kreu VI përcakton dispotat përfundimtare duke përcaktuar detyrat e organeve për miratimin e akteve nënligjore.

Projektligji ngarkohen Këshillin e Ministrave që të miratojë me vendim zbatimin e dispozitave të lidhura me organizimin e brendshëm të Agjencisë, përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Vlerësimit procedurat e hollësishme të funksionimit dhe ushtrimit të kompetencave të bordit, procedurat e hollësishme për publikimin, dorëzimin dhe vlerësimin e aplikimeve, shqyrtimin dhe vendimmarrjen për miratimin dhe dhënien e masave mbështetëse së bashku me rregullat e monitorimit si dhe të sanksionimit të shkeljeve.

Projektligji ngarkon ministrin përgjegjës për financat që të nxjerrë aktin nënligjor për mënyrën e zbatimit të përfitimit nga lehtësitë fiskale të lidhura me përjashtimet nga taksat sipas këtij ligji.

Së fundmi, ministri përgjegjës për ekonominë, brenda 3 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, duhet të përfundojë procedurat për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Vlerësimit të Startup-eve Inovative.

Neni 21 i projektligjit përcakton se ligji hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

## **VI. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT**

Për zbatimin e këtij projektligji ngarkohet Ministria përgjegjëse për ekonominë dhe financat si dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore brenda kompetencave të tyre.

## **VII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT**

Projektligji u hartua nga një grup pune i përbërë nga përfaqësues nga Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, me asistencën teknike të GIZ nëpërmjet projektit EU for Innovation.

## **VIII. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE**

Miratimi i këtij projektligji ka efekte financiare për buxhetin e shtetit pasi parashikon ngritjen e një agjencie autonome të re, si dhe do të sjellë si risi ngritjen e regjistrit dhe të portalit elektronik për Startup-et Inovative.



Sipas një vlerësimi paraprak është parashikuar që kostoja ekonomike për ngritjen e agjencisë dhe këtyre dy sistemeve do të mbulohen nga buxheti i shtetit.

**MINISTËR**  
*Anila DENAJ*  
**Anila DENAJ**

The seal is circular and contains the coat of arms of Albania in the center. The text around the perimeter of the seal reads "REPUBLIKA E ALBANI" at the top and "MINISTRI I TREGTISË DHE FINANCËVE" at the bottom.

**PROJEKT-LIGJ**  
**“PËR MBËSHTETJEN DHE ZHVILLIMIN E STARTUP - EVE INOVATIVE”**

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI

**KREU I - DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1**

**Qëllimi**

Qëllimi i këtij ligji është krijimi i një kuadri rregullator dhe institucional të favorshëm për krijimin dhe zhvillimin e Startup-eve Inovative në fushën e teknologjisë dhe inovacionit, për nxitjen e kërkimit, realizimit dhe përdorimit të ideve, modeleve, produkteve dhe proceseve të reja, të cilat sjellin risi në çdo fushë të ekonomisë.

**Neni 2**

**Objekti**

Ky ligj përcakton masat mbështetëse, organet shtetërore, kriteret, rregullat dhe procedurat që zbatohen për miratimin dhe mbështetjen e Startup-eve Inovative dhe krijimin e një eko-sistemi të favorshëm për to në Republikën e Shqipërisë.

**Neni 3**

**Përkufizimet**

~~Në këtë ligj, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:~~

- a) *Startup Inovativ* - është një shoqëri e regjistruar apo që planifikon të regjistrohet në regjistrin tregtar të Republikës së Shqipërisë, qëllimi i së cilës është të nisë realizimin dhe zhvillimin e një modeli biznesi, produkti apo shërbimi të ri, të veçantë dhe i zbatueshëm në praktikë, me një vlerë të lartë të shtuar teknologjike ose përmirësimin e ndjeshëm të modeleve të biznesit, produkteve apo shërbimeve ekzistuese, me potencial të lartë dhe global rritjeje.
- b) *Lehtësues të Startup-eve Inovative* – janë aktorët e ndryshëm të eko-sistemit dhe që ofrojnë programe dhe shërbime mbështetëse për Startup-et Inovative (përfshirë, por pa u kufizuar në; inkubatorë, përshpejtues, ofrues ambientesh dhe pajisjesh pune, mentorim, këshillim, trajnim, asistencë përgjatë zhvillimit të biznesit, qendra teknologjike dhe inovacioni, organizatorë eventesh, universitete, organizata kërkimore, ofrues të shërbimeve të konsulencës ligjore, financiare etj.) ose subjekte që i ofrojnë Startup-eve Inovative, financim, investim kapitali, investim kapitali risku apo engjëj biznesi.
- c) *Eko-sistemi i Startup-eve Inovative* – komuniteti i aktorëve të eko-sistemit, i cili përveçse nga Startup-et Inovative, formohet nga individë, subjekte dhe lloje të ndryshme organizatash që bashkëveprojnë, për të ndihmuar krijimin e Startup-eve të reja dhe rritjen e potencialit të tyre të biznesit. Aktorët e eko-sistemit zakonisht japin mbështetjen në segmente dhe në faza specifike të zhvillimit të Startup-eve Inovative.
- d) *Përshpejtues i Startup-eve Inovative* – një subjekt i cili ofron një program përshpejtimi dhe gjithashtu mund të sigurojë një investim kapitali për Startup-et Inovative të përzgjedhur. Qëllimi kryesor i përshpejtuesve të Startup-eve Inovative është ofrimi në favor të Startup-et Inovative, i njohurive, eksperiencës dhe rrjeteve të komunikimit për përmirësimin e veprimtarive të biznesit.
- e) *Program përshpejtues* - është një program që përmban disa aktivitete (p.sh: konferenca/seminare biznesi, këshillim, trajnim), i cili përzgjedh Startup-et Inovative përfituese, sipas procedurave të bazuara mbi thirrjet për aplikime. Programet përshpejtuese organizohen në bashkëpunim me mentorë dhe ekspertë të biznesit, industrisë dhe teknologjisë dhe mbështesin Startup-et Inovative, nismëtarët e ideve të biznesit, produktin ose shërbimin, përmirësimin e aftësive të ekipit dhe modelit të biznesit për zhvillimin, përmirësimin dhe zbatimin në praktikë, duke i bërë tërheqës Startup-et Inovative për thithjen e investitorëve të kapitalit.
- f) *Investim kapitali* - Kontributi në para në kapitalin e një shoqërie Startup-i Inovativ, i dhënë në këmbim të kuotave/aksioneve në një shoqëri tregtare.
- g) *“Engjëll biznesi”* - një investitor i cili me përvojën dhe me fondet e tij, ka kryer një investim kapitali në fazën fillestare të zhvillimit, në të paktën dy Startup-e Inovative, të huaj ose vendas.
- h) *Kapitali risku* - një investim në kapital i kryer në Startup-e Inovative me potencial rritjeje të shpejtë dhe fitimi, në të cilin, në shkëmbim të fondeve të vendosura në dispozicion, investitorët e kapitalit të riskut

- mund të përfitojnë një përqindje të pronësisë së shoqërisë, pagesë fikse, success fee apo forma të tjera.
- i) *Investim kapitali risku*- Një investim i plotë ose i pjesshëm në kapital, hua ose një kombinim i tyre, i dhënë një Startup-i Inovativ nga një investitor.
  - j) *Fond investimi* - Një fond investimesh i cili mbledh financimet nga një numër i ndryshëm investitorësh, dhe i cili i përdoret për investime kolektive, në dobi të investitorëve dhe në përputhje me politikat e fondit të investimit.
  - k) *Miratim* - është procesi i vlerësimit i kryer nga Bordi i Vlerësimit të Startup-eve Inovative, i cili verifikon nëse një projekt ide biznesi e paraqitur, plotëson kushtet dhe kriteret për tu kualifikuar si Startup Inovativ dhe për të përfituar masat mbështetëse sipas këtij ligji.
  - l) *Inkubim*- është procesi i mbështetjes, përgatitjes dhe i zhvillimit i një Startup-i Inovativ, në fazën fillestare të zhvillimit të tij.
  - m) *Marrëveshje bashkëpunimi*- është marrëveshja e lidhur ndërmjet Agjencisë dhe një startup-i inovativ, në të cilën përcaktohen kushtet e përfitimit të mbështetjes dhe shërbimeve përgjatë periudhës së inkubimit.

## KREU II MASAT MBËSHTETËSE PËR STARTUP-ET INOVATIVE

### Neni 4 Masat mbështetëse për Startup-et Inovative

1. Në fazën fillestare të zhvillimit të projekt idesë, individët apo subjektet të cilët janë nismëtarë të një Startup-i Inovativ, i cili ende nuk është regjistruar si subjekt tregtar në regjistrin tregtar, pas lidhjes së marrëveshjes së bashkëpunimit me Agjencinë, mund të përfitojnë:
  - a) Shërbimet e informacionit dhe konsulencës në lidhje detyrimet fiskale dhe procedurat ligjore që zbatohen në Republikën e Shqipërisë pa pagesë, të ofruara nga Agjencia Kombëtare për Startup-et Inovative "Startup Albania";
  - ~~b) Shërbimet e inkubimit, mentorimit dhe mbështetjes së projekt idesë, të ofruara nga Lehtësuesit e miratuar. Kushtet e përfitimit të shërbimeve bazohen në marrëveshjet e bashkëpunimit midis tyre dhe sipas kushteve të përcaktuara në marrëveshjen e bashkëpunimit që Lehtësuesi ka lidhur me Agjencinë.~~
2. Startup-et Inovative, të cilat janë miratuar, janë regjistruar në regjistrin tregtar, plotësojnë kriteret dhe zbatojnë procedurat e përcaktuara nga ky ligj, përgjatë periudhës së inkubimit, përjashtohen nga pagesa e taksave vendore të mëposhtme;
  - a) tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël;
  - b) taksës vendore mbi pasurinë e paluajtshme, kategoria ndërtesë, si dhe nga;
  - c) taksa vendore e tabelës.
3. Startup-et Inovative, të cilat janë miratuar, janë regjistruar në regjistrin tregtar, plotësojnë kriteret dhe zbatojnë procedurat e përcaktuara nga ky ligj, përgjatë periudhës së inkubimit, mbështeten me masat mbështetëse si vijon;
  - a) Mbështetje financiare, garantimin e një pjese të riskut të kreditimit, programe dhe masa të tjera mbështetëse sipas dispozitave të legjislacionit për Startup-et Inovative, të zbatuara nga Agjencia Kombëtare për Startup-et Inovative "Startup Albania";
  - ~~b) Grant, programe dhe masa mbështetëse, sipas dispozitave të legjislacionit për Startup-et Inovative, të zbatuara nga Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore;~~
  - c) Përfitojnë shërbimet e ofruara nga Lehtësuesit e miratuar të Startup-eve Inovative.

### Neni 5 Masat mbështetëse për Lehtësuesit e Startup-eve Inovative

1. Me qëllim ngritjen dhe zhvillimin e një eko-sistemi mbështetës për Startup-et Inovative, mbështeten Lehtësuesit e Startup-eve Inovative, të cilat janë miratuar, plotësojnë kriteret dhe zbatojnë procedurat e përcaktuara nga ky ligj.
2. Lehtësuesit e Startup-eve Inovative, të cilat janë miratuar, mbështeten me masat mbështetëse si vijon;
  - a) Përjashtohen nga pagesa e taksës vendore të ndërtesës, për sipërfaqet e tyre të biznesit, të cilat ia venë në dispozicion Startup-eve Inovative të miratuara, për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e tyre, si seli ligjore dhe ushtrim veprimtarie biznesi, nëpërmjet kontratave të huapërdorimit pa pagesë të lidhura me to. Përjashtimi nga taksa e ndërtesës zbatohet përgjatë kohëzgjatjes së kontratave të huapërdorimit, por nuk mund të jetë më e gjatë sesa periudha e inkubimit të Startup-it huapërdorues.

- b) Grante, programe dhe masa mbështetëse, sipas dispozitave të legjislacionit për Startup-et Inovative, të zbatuara nga Agjencia Kombëtare për Startup-et Inovative "Startup Albania";
- c) Grante, programe dhe masa mbështetëse, sipas dispozitave të legjislacionit për Startup-et Inovative, të zbatuara nga Njësitë e Vetëqeverisjes vendore.

#### **Neni 6**

#### **Kohëzgjatja e periudhës së inkubimit të Startup-eve Inovative**

1. Kohëzgjatja e periudhës së inkubimit të Startup-eve Inovative dhe e përfitimit të masave mbështetëse sipas këtij ligji është 24 muaj nga data e miratimit si Startup Inovativ.
2. Në raste të veçanta, për Startup-et Inovative, aktiviteti dhe përmasat e të cilave kërkojnë një kohëzgjatje më të madhe për realizimin e tyre, mund të garantohet mundësia e zgjatjes së periudhës së inkubimit, me vendim të Bordit të Vlerësimit të Startup-eve Inovative, sipas rregullave të përcaktuara me vendim nga Këshilli i Ministrave.

### **KREU III – KUADRI INSTITUCIONAL DHE ORGANET PËRGJEGJËSE PËR STARTUP-ET INOVATIVE**

#### **Neni 7**

#### **Organët përgjegjës**

Organet përgjegjëse në fushën e nxitjes, ndihmës dhe monitorimit të Startup-eve Inovative sipas këtij ligji janë;

- a) ministria përgjegjëse për ekonominë;
- b) njësitë e qeverisjes vendore;
- c) Agjencia Kombëtare për Startup-et Inovative "Startup Albania";
- d) Bordi i Vlerësimit të Startup-eve Inovative.

#### **Neni 8**

#### **Funksionet dhe kompetencat e ministrisë përgjegjëse për ekonominë**

Ministria përgjegjëse për ekonominë ka këto detyra:

- a) harton politikat, planet, strategjitë, aktet ligjore e nënligjore për zhvillimin e Startup-eve Inovative dhe i paraqet për miratim, pranë Këshillit të Ministrave;
- b) miraton fondet buxhetore për grantet, programet dhe masat mbështetëse të cilat i garantohen Startup-eve Inovative dhe që zbatohen nga Agjencia;
- c) koordinon zbatimin e politikave të zhvillimit të Startup-eve Inovative, në kuadër të zhvillimit ekonomik të përgjithshëm;
- d) mbikqyr veprimtarinë e Agjencisë Kombëtare për Startup-et Inovative "Startup Albania";
- e) emëron dhe shkarkon anëtarët e Bordit të Vlerësimit të Startup-eve Inovative.

#### **Neni 9**

#### **Njësitë e vetëqeverisjes vendore**

1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore, në përputhje me kompetencat e tyre dhe brenda territoreve të tyre, nxiten të miratojnë paketa fiskale lehtësuese, të zbatojnë programe dhe të ndërmarrin masa mbështetëse për mbështetjen e Startup-eve Inovative dhe Lehtësuesve të miratuar.
2. Në veçanti, njësitë e vetëqeverisjes vendore, mund të mbështesin duke:
  - a) Ofruar grante financiare dhe programe mbështetëse për Startup-et Inovative dhe Lehtësuesit e miratuar;
  - b) Ofruar Lehtësuesve të miratuar, ambiente, objekte apo sipërfaqe objektsh nën administrimin e tyre, pa pagesë, duke kushtëzuar përdorimin nga ana e tyre, për ofrimin e hapësirave të punës dhe shërbimeve ndaj Startup-eve Inovative të miratuar;
  - c) Ofruar Startup-eve Inovative të miratuar, objekte apo sipërfaqe objektsh nën administrimin e tyre, pa pagesë, me qëllim përdorimin e këtyre si seli ligjore dhe për ushtrimin e veprimtarive të tyre të biznesit, përgjatë periudhës së inkubimit.

#### **Neni 10**

#### **Agjencia Kombëtare për Startup-et Inovative**

1. Me qëllim zbatimin e detyrave sipas këtij ligji për mbështetjen e Startup-eve Inovative krijohet Agjencia Kombëtare për Startup-et Inovative, në vijim "Startup Albania" ose "Agjencia", si person juridik publik, buxhetor, me seli në Tiranë, në varësi të ministrit përgjegjës për ekonominë.

2. Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë drejton veprimtarinë e përditshme të saj dhe e përfaqëson atë në marrëdhëniet me të tretët. Emërimi dhe lirimi i Drejtorit të Agjencisë bëhet në përputhje nga Ministri përgjegjës për ekonominë sipas përcaktimit të Kodit të Punës.
3. Kriteret dhe procedurat për emërimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë cakton me udhëzim të ministrit përgjegjës për ekonominë.
4. Rekrutimi dhe marrëdhëniet e punës me personelin e Agjencisë kryhen në përputhje me Kodin e Punës.
5. Agjencia financohet:
  - a) Buxheti i shtetit
  - b) Fonde jo buxhetore nëpërmjet kontributeve të donatorëve, organizatave kombëtare apo ndërkombëtare
  - c) Kontributet e aktorëve të eko-sistemit të Startup-eve Inovative.
  - d) Fonde të tjera të ligjshme
6. Mënyra e organizimit dhe funksionimit të brendshëm të Agjencisë miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për ekonominë.
7. Struktura dhe organika e Startup Albania miratohen me urdhër të Kryeministrit, me propozim të ministrit përgjegjës për ekonominë.

#### Neni 11

#### Funksionet dhe kompetencat e Agjencisë Kombëtare për Startup-et Inovative

1. Agjencia Kombëtare për Startup-et Inovative "Startup Albania" ka këto funksione dhe kompetenca:
  - a) propozon politika, plane, strategji si dhe përmirësimin dhe ndryshimin e akteve ligjore e nënligjore për mbështetjen dhe zhvillimin e Startup-eve Inovative;
  - b) mbështet veprimtarinë e Startup-eve Inovative dhe Lehtësuesve të miratuar, nëpërmjet zbatimit të granteve, programeve dhe masave mbështetëse, ofrimit të shërbimeve të konsulencës dhe inkubimit, sipas kushteve të përcaktuara nga ky ligj dhe aktet nënligjore në zbatim të tij;
  - c) administron fondet buxhetore të alokuara për mbështetjen e Startup-eve Inovative dhe Lehtësuesit e miratuar duke i përdorur ato për dhënie në favor të aplikuesve përfitues, të granteve financiare dhe zbatimit të programeve dhe masave mbështetëse sipas këtij ligji;
  - d) merr në dorëzim aplikimet e paraqitura nga Startup-et Inovative dhe Lehtësuesit, të cilat ia përçojnë për miratim Bordit të Vlerësimit si dhe kryen njoftimet, komunikimet dhe shkëmbimet e dokumentacionit me aplikuesit;
  - e) harton modelin tip të "marrëveshjes së bashkëpunimit" që do të nënshkruhet mes agjencisë dhe startup-ve inovative;
  - f) lidh dhe monitoron zbatimin e marrëveshjeve me Startup-et Inovative dhe Lehtësuesit e miratuar të cilat përfitojnë grantet financiare, programet dhe masat mbështetëse sipas këtij ligji;
  - g) i propozon Bordit të Vlerësimit çregjistrimin dhe zbatimin e sanksioneve ndaj Startup-eve Inovative, të cilët nuk respektojnë kushtet e marrëveshjeve dhe kriteret e këtij ligji;
  - h) krijon, administron dhe përditëson portalin elektronik zyrtar të Startup-eve Inovative, i cili përmban informacionin e nevojshëm dhe lehtëson komunikimet dhe lidhjen midis aktorëve të ndryshëm të eko-sistemit të Startup-eve Inovative;
  - i) krijon, administron dhe përditëson regjistrin e Startup-eve Inovative, i cili përmban të dhënat mbi aplikimet e paraqitura, Startup-et dhe Lehtësuesit e miratuar;
  - j) organizon dhe promovon evente specifike, të fokusuar tek shkëmbimi i eksperiencave, këshillimi, mentorimi dhe krijimi i rrjeteve (*network*) për zhvillimin e Startup-eve Inovative;
  - k) promovon produktet dhe shërbimet e ofruara nga Startup-et Inovative brenda e jashtë vendit, duke bashkëpunuar me organizmat, komunitetin dhe subjektet që mbështetin Startup-et Inovative;
  - l) kryen monitorimin dhe vlerësimin e efikasitetit dhe ndikimit të granteve, programeve dhe masave mbështetëse të dhëna sipas këtij ligji;
  - m) mbledh, përpunon dhe analizon informacionin mbi kushtet, nevojat, kapacitetet e Startup-eve Inovative dhe Lehtësuesit e miratuar si dhe dinamikat dhe tendencat e tregut dhe eko sistemit të Startup-eve Inovative;
  - n) favorizon bashkëpunimin e aktorëve të eko-sistemit të Startup-eve Inovative, me organet publike, përfaqësuesit e biznesit dhe botën akademike, me qëllim krijimin e një kuadri rregullator dhe institucional të favorshëm dhe krijimit të një tregu funksional për Startup-et Inovative;
  - o) bashkëpunon me organizmat homologë, organizata dhe subjekte ndërkombëtare që veprojnë në fushën e nxitjes së Startup-eve Inovative, për lehtësimin e aksesit të Startup-eve vendase në tregjet ndërkombëtare dhe përfshirjen e tyre në programet ndërkombëtare të asistencës që ato ofrojnë;
  - p) nxit, mbështet e promovon frymën e sipërmarrjes dhe krijimin e shoqërive tregtare të reja të reja, sidomos tek të rinjtë, fokusimin në fushën e teknologjisë dhe inovacionit, si edhe përmirësimin e burimeve njerëzore, aftësive, edukimin, formimin profesional dhe menaxherial;
  - q) ushtron kompetencat e lidhura me zbatimin e detyrave të parashikuara nga ky ligj dhe nga aktet nënligjore të miratuara në zbatim të tij.

2. Programet e zbatuara nga Startup Albania në mbështetje të Startup-eve Inovative dhe Lehtësuesit e miratuar, përfshijnë, por pa u kufizuar:
  - a) Grante financiare në favor të Startup-eve Inovative të miratuar;
  - b) Programe dhe masa të tjera mbështetëse, të cilat përfshijnë por pa u kufizuar:
    - i. Ofrim i garancive shtetërore për financimin e Startup-eve Inovative nga institucionet bankare, financiare dhe mekanizmat e mikrokreditimit;
    - ii. Programe për mbledhjen e fondeve apo pjesëmarrjen në fonde të investimit të krijuara së bashku me kontributin e donatorëve, organizatave ndërkombëtare dhe investitorëve të kapitalit, në mbështetje të Startup-eve Inovative;
    - iii. Masa mbështetëse për organizimin e eventeve, takimeve, seminareve, konferenca apo të ngjashme, që kanë si qëllim krijimin e rrjeteve të bashkëpunimit dhe krijimin e një eko-sistemi të favorshëm për zhvillimin e Startup-eve Inovative;
  - c) Ofrim i shërbimeve të informacionit dhe konsulencës ligjore dhe fiskale, pa pagesë, në favor të Startup-eve Inovative dhe nismëtarëve të një projekt-ideje Startup-i Inovativ;
  - d) Grante financiare, programe të subvencionimit të kostove, programe dhe masa të tjera mbështetëse në favor të Lehtësuesve të miratuar të cilët ofrojnë shërbime ndaj Startup-eve Inovative të miratuar.
3. Fondet buxhetore për programet e zbatuara nga Startup Albania në mbështetje të Startup-eve Inovative dhe Lehtësuesit e miratuar, alokohen dhe miratohen nga ministri përgjegjës për ekonominë.
4. Masat mbështetëse të dhëna sipas këtij ligji në favor të Startup-eve Inovative dhe Lehtësuesve të miratuar, duhet të respektojnë rregullat, kufizimet dhe kriteret e zbatueshme nga legjislacioni i zbatueshëm për ndihmën shtetërore. Për këtë qëllim, miratimi dhe zbatimi i tyre, kryhet vetëm pas marrjes së mendimit paraprak nga organet shtetërore kompetente.

## Neni 12

### Bordi i Vlerësimit të Startup-eve Inovative

1. Për vlerësimin e aplikimeve, miratimin dhe dhënien e masave mbështetëse sipas këtij ligji, brenda Startup Albania krijohet Bordi i Vlerësimit të Startup-eve Inovative, si organ kolegjal i cili vepron në përputhje me dispozitat e zbatueshme për funksionimin e organeve kolegjalit të enteve publike dhe legjislacionit në fuqi.
2. Bordi i Vlerësimit të Startup-eve Inovative përbëhet nga nëntë anëtarë, si vijon:
  - a) dy përfaqësues nga ministria përgjegjëse për ekonominë;
  - b) dy përfaqësues nga ministria përgjegjëse për çështjet e mbrojtjes së sipërmarrjes;
  - c) dy përfaqësues të eko-sistemit të Startup-eve Inovative, të propozuar nga aktorët e këtij komuniteti, me eksperiencë pune dhe fokus në ndihmesën e zhvillimit të Startup-eve Inovative;
  - d) dy përfaqësues nga universitetet dhe bota akademike;
  - e) një përfaqësues i sipërmarrjes dhe biznesit, i përzgjedhur nga organizatat dhe komuniteti i biznesit.
3. Bordi i Vlerësimit të Startup-eve Inovative ushtron detyrat e mëposhtme:
  - a) Vlerëson aplikimet e paraqitura nga Startup-et Inovative dhe Lehtësuesit për miratimin dhe përfitimin e granteve financiare, programeve dhe masave mbështetëse të ofruara sipas këtij ligji;
  - b) kryen miratimin e Startup-eve Inovative, në rastet kur aplikuesit plotësojnë kriteret e parashikuara nga ky ligj,
  - c) kryen miratimin e Lehtësuesve të Startup-eve Inovative;
  - d) në përfundim të procesit të vlerësimit, miraton aplikimet fituese për përfitimin e granteve financiare, programeve dhe masave mbështetëse të ofruara nga Startup Albania sipas këtij ligji;
  - e) vendos mbi gregjistrimin dhe zbatimin e sanksioneve ndaj përfituesve që nuk respektojnë kushtet e marrëveshjes dhe kriteret e këtij ligji, të propozuara nga Startup Albania;
  - f) vendos për rastet përjashtimore të zgjatjes së periudhës së inkubimit, për Startup-et Inovative, aktiviteti dhe përmasat e të cilave kërkojnë një kohëzgjatje më të madhe për realizimin e tyre, në përputhje me rregullat e përcaktuara me vendim nga Këshilli i Ministrave.
4. Gjatë veprimtarisë së tyre, anëtarët e Bordit të Vlerësimit të Startup-eve Inovative parandalojnë dhe shmangin konfliktin e interesave, sipas legjislacionit në fuqi. Anëtarët e Bordit nuk marrin pjesë në proceset përzgjedhëse dhe vendimmarrëse, të cilat lidhen me situata apo çështje me konflikt interesi.
5. Mënyra dhe kriteret për përzgjedhjen e anëtarëve, shpërblimi i tyre, organizimi dhe procedurat e hollësishme të funksionimit dhe ushtrimit të kompetencave të Bordit të Vlerësimit të Startup-eve Inovative përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

## KREU IV

### KRITERET DHE PROCEDURAT E ZBATUESHME PËR MIRATIMIN DHE MBESHTETJEN PËR STARTUP-ET INOVATIVE DHE LEHTËSUESIT

## Neni 13

## Kushtet për miratimin dhe përfitimin e masave mbështetëse për Startup-et Inovative

Kushtet paraprake për miratimin dhe përfitimin e masave mbështetëse shtetërore nga Startup-et Inovative, janë si vijon:

- a) Aplikuesit duhet që të paraqesin një projekt-ide biznesi e cila ka si qëllim realizimin e ideve, modeleve, produkteve dhe proceseve të reja, të cilat sjellin risi teknologjike dhe inovacion, në çdo fushë të ekonomisë, e cila konsiderohet si inovative dhe miratohet si e tillë nga Bordi i Vlerësimit të Startup-eve Inovative;
- b) Për zbatimin e projekt-idesë dhe përfitimin e masave mbështetëse, aplikuesit duhet të lidhin marrëveshjen e zbatimit me Agjencinë;
- c) Aplikuesit, në rast se nuk janë ende subjekt tregtar i regjistruar, duhet të regjistrohen në vijim në regjistrin tregtar, brenda afatit të përcaktuar në marrëveshjen e zbatimit të lidhur me Agjencinë;
- d) Subjekti tregtar i regjistruar duhet të plotësojë kriteret për tu kualifikuar si ndërmarrje, mikro, e vogël apo e mesme, autonome, sipas përcaktimeve të legjislacionit për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, përgjatë periudhës së inkubimit, nëse përfiton masa mbështetëse sipas këtij ligji;
- e) Subjekti tregtar i regjistruar nuk duhet të shpërndajë dividend apo forma të tjera fitimi, përgjatë periudhës së inkubimit, nëse përfiton masa mbështetëse sipas këtij ligji;
- f) Subjekti tregtar i regjistruar e ka të ndaluar dhënien e shpërblimeve apo pagave për ortakët, aksionarët, administratorët apo anëtarët e organeve drejtuese, si edhe të punësuarve dhe konsulentëve, në vlera të cilat tejkalojnë kufirin e pesëfishit të pagave mujore minimale, përcaktuar sipas legjislacionit përkatës, përgjatë periudhës së inkubimit, nëse përfiton masa mbështetëse sipas këtij ligji;
- g) Startup-i Inovativ i miratuar duhet të përfitojë shërbime të ofruara nga Lehtësuesit e miratuar, përgjatë periudhës së inkubimit.

### Neni 14

#### Miratimi dhe përfitimi i masave mbështetëse për Startup-et Inovative

1. Nisma e një Startup-i Inovativ mund të ndërmerret nga çdo individ vendas apo të huaj, të cilët kërkojnë të aplikojnë ide inovative në fushën e teknologjisë dhe inovacionit, në Republikën e Shqipërisë.
2. Me qëllim përfitimin e masave mbështetëse të ofruara nga ky ligj, propozuesit e një Startup-i Inovativ, aplikojnë për miratimin e tyre tek Agjencia e Startup-eve Inovative, duke paraqitur një projekt ide inovative së bashku me dokumentacionin shoqërues.
3. Agjencia i përcjell aplikimin dhe dokumentacionin shoqërues Bordit të Vlerësimit të Startup-eve Inovative dhe kryen komunikimet dhe njoftimet e nevojshme përgjatë procesit të aplikimit midis Bordit dhe aplikuesve.
4. Bordi i Vlerësimit të Startup-eve Inovative kryen vlerësimin e projekt idesë dhe dokumenteve të paraqitura dhe nëse ajo i plotëson kushtet e përcaktuara nga ky ligj, miraton aplikuesin si Startup Inovativ dhe Agjencia e regjistron atë në regjistrin e Startup-eve Inovative.
5. Për realizimin e projektit, transformimit të idesë në një shoqëri tregtare të regjistruar dhe përfitimin e masave mbështetëse, aplikuesit lidhin marrëveshjen e zbatimit me Agjencinë e Startup-eve Inovative.
6. Aplikuesi i miratuar si Startup Inovativ, ka të drejtën që të përfitojë lehtësitë fiskale, grantet financiare, programet dhe masat mbështetëse të ofruara nga organet shtetërore, si edhe shërbimet e ofruara nga Lehtësuesit e miratuar, sipas përcaktimeve të këtij ligji.
7. Agjencia publikon grantet, programet dhe masat mbështetëse të cilat do të zbatohen në mbështetje të Startup-eve Inovative dhe fton aplikuesit të paraqesin propozimet e tyre. Përzgjedhja e aplikimeve kryhet bazuar mbi procedurë konkurruese.
8. Rregullat për procedurat konkurruese për miratimin dhe dhënien e masave mbështetëse ndaj aplikuesve dhe lidhjen e marrëveshjes së bashkëpunimit, rastet e zgjatjes së periudhës së inkubimit si dhe marrëveshja tip e bashkëpunimit, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

### Neni 15

#### Kushtet për miratimin dhe përfitimin e masave mbështetëse për Lehtësuesit e Startup-eve Inovative

Kushtet paraprake për miratimin dhe përfitimin e masave mbështetëse shtetërore nga Lehtësuesit e Startup-eve Inovative, janë si vijon:

- a) Duhet të jenë subjekte tregtare të regjistruara në regjistrin tregtar shqiptar ose organizata jo fitim prurëse të regjistruara;
- b) Duhet të dëshmojnë kapacitetet dhe/ose përvojën e tyre për projektet e realizuara në mbështetjen e Startup-eve Inovative;
- c) Duhet të deklarojnë masat mbështetëse dhe shërbimet që ofrojnë për mbështetjen e Startup-eve Inovative, të cilat mund të përfshijnë, por pa u kufizuar:

- i. Ofrimin e ambienteve dhe hapësirave të punës, duke mundësuar regjistrimin e selive ligjore dhe ushtrimin e veprimtarive të biznesit në favor të Startup-eve Inovative;
  - ii. Ofrimin e mjeteve dhe pajisjeve të punës, si dhe shërbimeve të biznesit, të tilla si zyra, ambiente dhe pajisje pune, kancelari, shërbime interneti, furnizim me energji dhe ujë;
  - iii. Ofrimin e programeve të përshpejtitimit, duke ofruar mentorim, këshillimi, trajnim nëpërmjet ekspertësh të kualifikuar apo duke mundësuar kapital investimi për Startup-et Inovative, drejtpërdrejt apo nëpërmjet investitorëve të kapitalit;
  - iv. Ofrimin e shërbimeve të konsulencës profesionale të tilla si IT, shërbime konsulence ligjore dhe fiskale;
  - v. Ofrimin e shërbimeve të mentorimit dhe këshillimit për realizimin dhe zhvillimin e ideve të biznesit;
  - vi. informacion mbi tregun vendas dhe të huaj;
  - vii. informacion mbi produktet, shërbimet dhe teknologjitë e inovacionit;
  - viii. informacion për krijimin e rrjeteve dhe lidhjen me rrjetet ekzistues të Startup-eve Inovative;
  - ix. informacion mbi masat mbështetëse që i ofrohen Startup-eve Inovative.
- d) Duhet të dëshmojnë asistencën e dhënë në favor të Startup-eve Inovative, nëpërmjet kontratave të lidhura me to dhe shërbimeve apo programeve të zbatuara.

#### Neni 16

#### Miratimi dhe përfitimi i masave mbështetëse për Lehtësuesit e Startup-eve Inovative

1. Me qëllim përfitimin e masave mbështetëse të ofruara nga ky ligj, Lehtësuesit e Startup-eve Inovative, aplikojnë për miratimin e tyre tek Agjencia e Startup-eve Inovative, duke paraqitur dokumentacion që provon plotësimin e kushteve sipas këtij ligji.
2. Agjencia i përcjell aplikimin dhe dokumentacionin shoqërues Bordit të Vlerësimit të Startup-eve Inovative dhe kryen komunikimet dhe njoftimet e nevojshme përgjatë procesit të aplikimit midis Bordit dhe aplikuesve
3. Bordi i Vlerësimit të Startup-eve Inovative kryen vlerësimin e aplikimit dhe dokumenteve të paraqitura dhe nëse plotësohen kushtet e përcaktuara nga ky ligj, miraton aplikuesin dhe Agjencia e regjistron atë në regjistrin e Lehtësuesve të Startup-eve Inovative.
4. Pas miratimit, për përfitimin e masave mbështetëse, Lehtësuesit lidhin marrëveshjen e zbatimit me Agjencinë.
5. Pas miratimit, Lehtësuesit e Startup-eve Inovative, kanë të drejtën që të aplikojnë për përfitimin e lehtësive fiskale, granteve financiare dhe masave mbështetëse të ofruara nga organet shtetërore, sipas përcaktimeve të këtij ligji.
6. Agjencia publikon grantet, programet dhe masat mbështetëse të cilat do të zbatohet në mbështetje të Lehtësuesve të Startup-eve Inovative dhe fton aplikuesit të paraqesin propozimet e tyre. Përzgjedhja e aplikimeve kryhet bazuar mbi procedura konkurruese. Në raste të pamjaftueshmërisë së fondeve buxhetore të vëna në dispozicion, vlerësimi kryhet bazuar mbi kritere të cilat vlerësojnë cilësinë e shërbimeve të ofruara në favor të Startup-eve Inovative.
7. Rregullat për procedurat konkurruese për miratimin dhe dhënien e masave mbështetëse ndaj aplikuesve, si dhe marrëveshja tip e bashkëpunimit, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

#### Neni 17

#### Vlerësimi dhe monitorimi i Startup-eve Inovative dhe Lehtësuesve

1. Pas miratimit, përgjatë periudhës së inkubimit dhe/ose periudhës përgjatë të cilës përfitojnë masa mbështetëse sipas këtij ligji, Startup-et Inovative dhe Lehtësuesit, vlerësohen dhe monitorohen periodikisht nga Agjencia e Startup-eve Inovative, me qëllim verifikimin e përputhshmërisë së zbatimit të kriterëve të miratimit dhe kushteve të marrëveshjeve të lidhura për përfitimin e masave mbështetëse.
2. Startup-et Inovative dhe Lehtësuesit e miratuar, kanë detyrimin e raportimit dhe vënies në dispozicion të dokumenteve të kërkuara në favor të Agjencisë së Startup-eve Inovative, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara në marrëveshjen e zbatimit.
3. Rregullat për kryerjen e monitorimit, raportimet dhe dokumentacionin e nevojshëm që duhet të paraqesin përfituesit e masave mbështetëse, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

#### KREU V

#### ÇREGJISTRIMI DHE SANKSIONET ADMINISTRATIVE

#### Neni 18

#### Rastet e çregjistrimit të Startup-eve Inovative dhe Lehtësuesve



1. Startup-i Inovativ çregjistrohet nga regjistri dhe nuk përfiton më masat mbështetëse të ofruara nga ky ligj në rastet kur:
  - a) Mbaron periudha e inkubimit sipas marrëveshjes së zhvillimit lidhur me Agjencinë e Startup-eve Inovative;
  - b) Bordi i Vlerësimit ka vendosur çregjistrimin e tij si pasojë e shkeljes së kritereve ligjore apo të kushteve të marrëveshjes së zbatimit;
  - c) Verifikohet se ka kryer mashtrim apo deklarime të rreme dhe/ose ka paraqitur dokumente false;
  - d) Subjekti/individët themelues/ortakët e Startup-it Inovativ dënohen nga gjykata për një vepër penale që lidhet me aktivitetin tregtar, me vendim të formës së prerë;
  - e) Individët propozues apo subjekti aplikues heqin dorë vullnetarisht nga vazhdimësia e realizimit të projekt-idesë apo biznesit.
2. Lehtësuesi i Startup-eve Inovative çregjistrohet nga regjistri dhe nuk përfiton më masat mbështetëse të ofruara nga ky ligj në rastet kur:
  - a) Bordi i Vlerësimit ka vendosur çregjistrimin e tij si pasojë e shkeljes së kritereve ligjore apo të kushteve të marrëveshjes së zbatimit;
  - b) Verifikohet se ka kryer mashtrim apo deklarime të rreme dhe/ose ka paraqitur dokumente false;
  - c) Subjekti tregtar, ortakët apo anëtarët e organeve administruese dhe mbikqyrëse, rezultojnë të dënuar nga gjykata për një vepër penale që lidhet me aktivitetin tregtar, me vendim të formës së prerë.
3. Rregullat, procedurat dhe dokumentacioni i nevojshëm për vlerësimin dhe vendimmarrjen në lidhje me çregjistrimin e Startup-eve Inovative apo Lehtësuesve, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

#### Neni 19

#### Sanksionet dhe masat administrative

1. Shkeljet e dispozitave të këtij ligji, kur nuk përbëjnë vepër penale përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen sipas dispozitave të këtij neni.
2. Përbëjnë shkelje të lehta administrative dhe sanksionohen me gjobë nga Bordi i Vlerësimit të Startup-eve Inovative, rastet e mëposhtme:
  - a) Mos raportimi periodik sipas parashikimeve ligjore dhe marrëveshjes së zbatimit, me vlerë 50,000 lekë;
  - b) Mos zbatimi i projekt – idesë së miratuar sipas parashikimeve ligjore dhe marrëveshjes së zbatimit, me vlerë 20,000 lekë.
3. Në rast të shkeljeve të parashikuara sipas pikës 2 të këtij neni, Bordi i Vlerësimit të Startup-eve Inovative vendos pezullimin e përkohshëm dhe ndërprerjen e përfitimit të masave mbështetëse, deri në përmbushjen e saktë të detyrimeve.
4. Përbëjnë kundërvajtje të rënda administrative dhe sanksionohen me gjobë nga Bordi i Vlerësimit të Startup-eve Inovative, rastet e mëposhtme:
  - a) Ndryshimi thelbësor i plan biznesit pa miratimin e Bordit të Vlerësimit të Startup-eve Inovative, me vlerë 500,000 lekë;
  - b) Paraqitja e informacioneve të rreme përgjatë aplikimit dhe periudhës së monitorimit, me vlerë 1,000,000 lekë;
  - c) Shkelja e dispozitave ligjore mbi të drejtën e autorit, pronësinë intelektuale dhe industriale, me vlerë 1,000,000 lekë;
  - d) Shpërdorimi apo keqpërdorimi i fondeve, në ndryshim nga plan biznesi i miratuar, me vlerë 1,000,000 lekë;
  - e) Shpërndarja e dividendit, shpërblimeve apo formave të tjera të fitimit, përgjatë periudhës së inkubimit, nëse përfiton masa mbështetëse, në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, me vlerë 1,000,000 lekë.
5. Në rast të shkeljeve të rënda administrative të parashikuara sipas pikës 4 të këtij neni, Bordi i Vlerësimit të Startup-eve Inovative, përveç aplikimit të gjobës, vendos çregjistrimin e menjëhershëm dhe përjashtimin e tij, pa të drejtë ri-aplikimi në të ardhmen. Çregjistrimi shkakton automatikisht humbjen e të drejtës së subjekteve për përfitimin nga masat mbështetëse si edhe detyrimin për kthimin e çdo shume të përfituar sipas këtij ligji.
6. Autoriteti kompetent për vendosjen e gjobës është Bordi i Vlerësimit të Startup-eve Inovative.
7. Procedura e konstatimit, vendosjes, ankimit dhe ekzekutimit të gjobës bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për kundërvajtjet administrative.

#### KREU VI

#### DISPOZITA TË FUNDIT DHE KALIMTARE

#### Neni 20

#### Dispozitë kalimtare

Deri në krijimin e Agjencisë Kombëtare për Startup-et Inovative, funksionet e saj kryhen nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve.

#### **Neni 21**

##### **Aktet nënligjore**

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 2 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të nenit 6, pika 2; të nenit 10 pika 5; të nenit 12, pika 5, nenit 14, pika 8; nenit 16, pika 7; nenit 17, pika 3; dhe të nenit 18, pika 3 të këtij ligji.
2. Ngarkohet ministri përgjegjës për financat që, brenda 2 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktin nënligjor në zbatim të neneve 4, pika 4 dhe nenit 5, pika 3 të këtij ligji.
3. Ministri përgjegjës për ekonominë, brenda 3 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, ndjek procedurat e nevojshme, për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Vlerësimit të Startup-eve Inovative sipas përcaktimeve të këtij ligji.

#### **Neni 22**

##### **Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Gramoz Ruçi**

Miratuar në datën \_\_/\_\_/2020